

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XX, nr. 6165
E shtunë, 14 nëntor 2020
çmimi 0.40 €

Qeveria ndan 1.1 milion euro për "Trepçën" IFAQE 9



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

FLET PËR "EPOKËN E RE", SHKËLZEN MALIQI IFAQE 4-5

GJYKATA SPECIALE E KA BILETËN E PARAPAGUAR PËR DËSHTIM



Analisti politik Shkëlzen Maliqi ka thënë se Gjykata Speciale e ka biletën e parapaguar për dështim pasi nuk ka gjetur prova për akuzën kryesore nga raporti i Dick Martit për "trafikim organesh". Në këtë

intervistë dhënë gazetës "Epoka e re", ai ka thënë se paraqitja dhe qëndrimi i katër të akuzuarve të parë para Dhomave të Specializuara ka qenë dinjitoze dhe me respekt për gjykatën. Maliqi ka

vlerësuar se Serbia nacionaliste, e cila vazhdimisht ka shtrembëruar dhe falsifikuar historinë e marrëdhënieve me shqiptarët, nuk do të mund ta kriminalizojë luftën e UÇK-së



PËRHAPJE E MADHE E COVIDIT NË KOSOVË, 963 RASTE TË REJA NË 24 ORËT E FUNDIT IFAQE 5

Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës (IKShPK) ka njoftuar se në 24 orët e fundit janë konfirmuar edhe 963 raste të reja me Covid-19 në vendin tonë. IKShPK-ja ka njoftuar se brenda 24 orëve janë raportuar edhe 13 raste të të vdekurve nga ky virus

KOSOVA DHE SHQIPËRIA REAGUJNË NDAJ KËRCIMIT TË VUÇIQIT PËR LUFTË IFAQE 2



OPINION

MASHTRIMI PUBLIK I
EKATERINA TRANDAFILOVËS
NGA GJYKATA SPECIALE
NJËETNIKE! F. 11

KMDLNj



AKTUALE

GASHI: QEVERIA HOTI
TË SHKOJË NË SHTËPI F. 3

QEVERIA NDRYSHON PLANIN
LEGJISLATIV, TËRHIQEN DISA
PROJEKTILIGJE F. 7



EKONOMI

ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT
TË KOSOVËS ANËTARËSOHET
NË EUROSAT F. 8

ATK-ja DHE DOGANA RRISIN
BASHKËPUNIMIN F. 8

KULTURË

'PUSHTETARËT E
MJEGULLNAJËS',
NJË LIBËR QË
PASURON
MENDIMIN POLITIK
SHQIPTAR F. 14



Lulëzim
ETEMAJ

SPORT

SFIDA INTERESANTE NË
SUPERLIGËN E BASKETBOLLIT F. 14

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçishtë-Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP S.H.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Mblidhen 2 miliardë dollarë për vaksinën kundër Covid-19 për vendet e varfra

NJU-JORK, 13 NËNTOR - Një program i Organizatës Botërore të Shëndetësisë dhe grupi për vaksina GAVI kanë mbledhur mbi 2 miliardë dollarë të cilat do të përdoren për të blerë dhe shpërndarë në vendet e varfra vaksinën kundër koronavirusit. Megjithatë, ata thonë se kjo shumë nuk është e

mjaftueshme që të gjitha vendet e varfra të furnizohen me vaksinën potenciale kundër sëmundjes Covid-19, që e shkakton koronavirusi. Aleanca GAVI ka njoftuar se këto mjete do t'i lejojnë COVAX-it - programit të OBSH-së që ka për qëllim mbledhjen e fondeve për zbulimin e vaksinës për Covid-19 që të

blejë një miliard doza të vaksinës, për 92 shtete, të cilat nuk kanë mundësi që t'i blejnë vet.

Edhe pesë miliardë dollarë të tjera duhet të mblidhen deri më 2021, në mënyrë që të blihen doza të vaksinës kundër Covid-19, vaksinë e cila ende nuk është zbuluar. Por, kompania amerikane "Pfizer"

dhe ajo gjermane "BioNTech" javën e kaluar njoftuan se vaksina e tyre kundër koronavirusit, sipas studimeve të para, ka treguar se është efektive deri në 90 për qind. Këto kompani kanë shprehur interesimin, që sapo vaksina e tyre të miratohet për përdorim, ta furnizojnë programin COVAX me doza të nevojshme.



Kosova dhe Shqipëria reagojnë ndaj kërcimit të Vuçiqit për luftë

PRISHTINË, 13 NËNTOR (ER) - Përfaqësues të institucioneve të Kosovës dhe të Shqipërisë kanë reaguar ndaj deklaratës së presidentit serb, Aleksandër Vuçiq, i cili ka thënë të enjten se një konflikt i llojit të Nagorno Karabakut mund të ndodhë në Kosovë nëse përpjekjet për kompromis dështojnë.

Ushtruesja e detyrës e presidentit të Kosovës, Vjosa Osmani, ka thënë se pret që komuniteti ndërkombëtar të reagojë ndaj "kërcënimit" të presidentit të Serbisë, Aleksandër Vuçiq, për "luftë të dhunshme". "Unë pres që Bashkimi Evropian dhe NATO-ja t'i përgjigjen këtij kërcënimi për luftë të dhunshme, të bërë nga Vuçiqi", ka shkruar Osmani në "Twitter".

Ndërkaq kryeministri Avdullah Hoti ka thënë se deklaratimet e presidentit të Serbisë, Aleksandër Vuçiq, nuk janë në dobi të normalizimit të marrëdhënieve midis dy vendeve, arritjes së marrëveshjes përfundimtare dhe njohjes reciproke.

Hoti thekson se ky deklaram është në kundërshtim me të gjitha zotimet që Serbia i ka bërë, nën garancitë e faktorit ndërkombëtar, për paqen e qëndrueshme dhe zhvillimin ekonomik të rajonit. "Qeveria e Republikës së Kosovës vazhdon të mbetet e përkushtuar në rolin e saj konstruktiv në të mirë të



paqes, stabilitetit dhe prosperitetit të gjithë rajonit. Qeveria e Republikës së Kosovës pret nga Bashkimi Evropian dhe nga NATO-ja të reagojë ndaj këtyre provokimeve. Qeveria e Republikës së Kosovës do ta vazhdojë angazhimin për anëtarësim sa më të shpejtë të vendit në NATO, Bashkimin Evropian dhe të gjitha institucionet relevante ndërkombëtare, si një vlerë e shtuar për zhvillimin e

demokracisë dhe paqes në botë", ka thënë Hoti.

Edhe presidenti i Shqipërisë, Ilir Meta, e ka komentuar deklaratën e presidentit të Serbisë, Aleksandër Vuçiq, i cili ka folur për një konflikt të mundshëm me Kosovën. Meta ka thënë se të gjithë duhet të mësohen të jetojnë me Kosovën si shtet i pavarur, qoftë në Serbi apo vendet e tjera, qoftë në Shqipëri, për ata që, sipas tij, nuk e kanë ende të qartë këtë gjë. "Gjykata

Ndërkombëtare e Drejtësisë e ka dhënë përgjigjen prej kohësh, çdo pretendimi të ngritur nga ata që ju ka ngelur ora para 20 vjetësh. Të gjithë duhet të mësohen të jetojnë me Kosovën si shtet i pavarur, jo vetëm në Serbi e vende të tjera, por edhe në Shqipëri, për ata që nuk e kanë të qartë", ka thënë Meta.

Edhe kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, ka folur për deklaratën e fundit të presidentit serb, Aleksandër

Vuçiq, i cili kërcënoi Kosovën me luftë. Sipas Ramës, nuk ka asnjë mundësi që Kosova dhe Serbia të përfshihen në luftë. "Për çfarë lufte flitet. Çfarë lufte provokon Vuçiqi. Serbia e ka humbur luftën. Kosova është një shtet i pavarur dhe demokratik. Po, Kosova ka bërë shumë gabime në marrëdhëniet diplomatike dhe ka humbur shumë terren, por nuk ka shanse për gjëra të tjera. Ato janë deklarata të kota", ka deklaruar Rama.

Zyrtarë të NATO-s nuk kanë pranuar t'i komentojnë deklaratat e presidentit të Serbisë, Aleksandër Vuçiq. Në pyetjen e "Radios Evropa e Lirë", se si e sheh NATO paralelen që ka tërhequr Vuçiqi midis Kosovës dhe Nagorno Karabakut, nga selia e aleancës ushtarake thanë se "misioni i KFOR-it [në Kosovë], i udhëhequr nga NATO-ja, mbetet plotësisht i përqendruar në zbatimin e mandatit nga Kombet e Bashkuara, për të ofruar siguri dhe liri të lëvizjes për të gjitha komunitetet në Kosovë". "Ne gjithashtu vazhdojmë ta mbështesim dialogun midis Beogradit dhe Prishtinës, me ndihmën e BE-së, si zgjidhje të vetme të përhershme politike për stabilitetin në Kosovë dhe në rajonin e gjerë të Ballkanit Perëndimor", ka thënë një zyrtar i NATO-s në një përgjigje me shkrim për "Radion Evropa e Lirë".

Ish-kryeministri kroat dënohet për korrupsion

Zagreb, 13 nëntor - Ish-kryeministri i Kroacisë, Ivo Sanader, është dënuar me tetë vjet burgim, pasi është gjetur fajtor për krijimin e fondeve për partinë e tij konservatore HDZ, duke marrë para nga kompanitë publike përmes një agjencie

të marketingut. Sanader ka hedhur poshtë të gjitha akuzat për korrupsion dhe pritet që ta apelojë këtë vendim të gjykatës.

Ky ishte një rigjykim i një rasti të mëhershëm, ku Sanader ishte dënuar me nëntë vjet burgim në vitin

2013, por vendimi ishte anuluar nga Gjykata Supreme për shkak se ishin gjetur shkelje procedurale. Sanader, 67 vjeç, ka qenë kryeministër i Kroacisë në vitin 2003 deri në vitin 2009, kur dhe u largua nga ky post pa dhënë asnjë shpjegim.



Prokuroria Speciale ka bërë kërkesë për caktimin e paraburgimit ndaj tetë të dyshuarve

PRISHTINË, 13 NËNTOR (ER) - Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës ka bërë kërkesë për caktimin e masës së

paraburgimit në Gjykatën Themelore në Prishtinë, Departamenti Special, në afat prej 30-ditësh, ndaj tetë (8) të

dyshuarve me inicialet A.K., K.B., F.G., A.S., H.K., L.B., L.B., E.Z., për veprat penale "Mashtrimi" nga neni 323, paragrafi 4, lidhur

me nenin 31 të KPK-së, si dhe "Pjesëmarrja apo organizimi i grupit kriminal të organizuar" nga neni 277 i KPK-së.



Lidhur me zhvillimet e fundit në vend, deputeti i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Kujtim Gashi, ka mbajtur të premtën konferencë për media

Gashi: Qeveria Hoti të shkojë në shtëpi

Deputeti i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Kujtim Gashi, ka kritikuar qeverinë Hoti për mospunë. Në një konferencë për media Gashi ka thënë se kjo qeveri duhet sa më parë të ikë. "Është një qeveri që duhet të shkojë në shtëpi sa më herët, sepse është e paaftë për të qeverisur dhe për ta menaxhuar pandeminë dhe ndihmuar ekonominë", ka thënë Gashi

EPOKA ERE **Qendresa RAMA**

PRISHTINË, 13 NËNTOR - Deputeti i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Kujtim Gashi, ka mbajtur të premtën një konferencë për media. Në këtë konferencë deputeti Gashi ka denoncuar dy qeveritë e fundit, Kurti dhe Hoti për, siç ka thënë, "pa ide, pa vizion dhe pa ndjeshmëri për qytetarin e Kosovës", në një kohë pandemie dhe kur ata kishin më së shumti nevojë. "Sot bëhen tetë muaj apo 245 ditë nga shfaqja e pandemisë Covid-19 në Kosovë. Shëndeti publik i popullatës po rëndohet çdo ditë me rritje të numrit të infeksioneve dhe numrit të të vdekurve, mungesë të kapaciteteve spitalore, ekonomi buzë kolapsit, mbyllje të bizneseve, punëtorë që mbesin pa punë çdo ditë dhe dhjetëra-mijëra familje janë zhytur në varfëri sipas Bankës Botërore", ka thënë Gashi.

Më tej deputeti i PDK-së ka thënë se dy partitë, LV-ja dhe LDK-ja, që në tetorin e vitit të kaluar mashtruan qytetarët e Kosovës me parulla boshe për

"qeveri të shpresës" janë kthyer në "mbytëse të shpresës" së qytetarëve të Kosovës. "Jemi sot në këtë konferencë për t'i rikujtuar edhe propozimet e Partisë Demokratike të Kosovës të para tetë muajve në vlerë prej 320 milionë eurosh, e njohur si 'pako emergjente' për bizneset dhe punëtorët e sektorit privat, që në fillim ish-qeveria Kurti, e më vonë edhe kjo Hoti e refuzuan, duke shikuar interesat e ngushta politike e partiake para interesit të qytetarëve. Me këtë rast, PDK-ja kishte ofruar edhe 24 votat e saj për këtë pako", ka thënë Gashi.

Gashi ka thënë se arroganca dhe injoranca e kësaj qeverie ka bërë që vendi ynë tash e sa kohë të mbetet pa pako ekonomike, e cila do t'i adresonte problemet me pandemi dhe ekonomi. Për më tepër, në vend se t'i ndihmojë bizneset, kjo qeveri ka vendosur ta mbyllë përsëri vendin. "Nga një përlllogaritje e deritanishme, del se për 245 ditë të pandemisë shuma mesatare që një punëtor ka përfituar nga qeveria është qesharake dhe, hiç më pak, a



më shumë se 2.60 euro në ditë për një punëtor. Partia Demokratike e Kosovës e konsideron skandaloze situatën kur ekonomia nuk përkrahet e mbështetet dhe qeveria vendos ta mbyllë edhe më shumë atë, e veçmas gastronominë, pa ndonjë vizion dhe plan të mirëmenaduar", ka thënë Gashi.

Duke parë keqmenaxhimin e situatës, deputeti Gashi ka thënë se kjo qeveri sa më parë duhet të ikë. "Pra, është një qeveri që duhet të shkojë në shtëpi sa më herët, sepse është e paaftë për të qeverisur dhe për ta menaxhuar pandeminë dhe ndihmuar ekonominë", ka thënë Gashi.

Duke folur për masat e fundit

që ka ndërmarrë qeveria, Gashi ka thënë se me vendimet e paanalizuara mirë, kjo qeveri vetëm sa do ta rëndojë edhe më shumë krizën ekonomike, duke mbyllur shumë biznese dhe duke lënë pa punë mijëra punëtorë të sektorit privat, duke prodhuar kështu një krizë të re sociale.

Shërbimi Korrektues i Kosovës bëhet me Gardë Ceremoniale



PRISHTINË, 13 NËNTOR (ER) - Duke u bazuar në autoritetin dhe në Ligjin për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, drejtori i përgjithshëm i Shërbimit Korrektues të Kosovës, Nehat Thaçi, ka nxjerrë vendim për themelimin e Gardës Ceremoniale të Shërbimit Korrektues të Kosovës. Garda Ceremoniale e

Shërbimit Korrektues të Kosovës do të veprojë dhe do të jetë aktive vetëm në raste të caktuara ceremoniale. Kriteret për përzgjedhjen e zyrtarëve, të cilët do të jenë pjesë e gardës ceremoniale dhe rregullat për funksionimin e gardës do të përcaktohen me akt të veçantë. "Shërbimi Korrektues i Kosovës çdoherë

do të jetë i përkushtuar për avancim të mëtutjeshëm dhe reforma të vazhdueshme, me qëllim të të qenit institucion profesional, besueshëm dhe konkurrent me institucionet korrektuese të shteteve demokratike dhe moderne", është bërë me dije në njoftimin e Shërbimit Korrektues të Kosovës.



FLET PËR "EPOKËN E RE", SHKËLZEN MALIQI

GJYKATA SPECIALE E KA BILETËN E PARAPAGUAR PËR DËSHTIM

Analisti politik Shkëlzen Maliqi ka thënë se Gjykata Speciale e ka biletën e parapaguar për dështim pasi nuk ka gjetur prova për akuzën kryesore nga raporti i Dick Martit për "trafikim organesh". Në këtë intervistë dhënë gazetës "Epoka e re", ai ka thënë se paraqitja dhe qëndrimi i katër të akuzuarve të parë para Dhomave të Specializuara ka qenë dinjitoze dhe me respekt për gjykatën. Maliqi ka vlerësuar se Serbia nacionaliste, e cila vazhdimisht ka shtrembëruar dhe falsifikuar historinë e marrëdhënieve me shqiptarët, nuk do të mund ta kriminalizojë luftën e UÇK-së

EULEX-it në shumë raste pa sukses për shkak të mungesës së provave, mendoj se edhe në këtë gjykatë nuk do të ketë zbardhje spektakulare. Përkundrazi, pasi që është vërtetuar se nuk është gjetur asnjë provë për akuzën kryesore nga raporti i Dick Martit mbi "krimin makabër të trafikimit të organeve", që i mvishej Grupit të Drenicës, besoj se Gjykata Speciale e ka biletën e parapaguar për dështim. Kjo çështje u hap edhe në fjalën hyrëse të mbrojtësit të ish-presidentit Hashim Thaçi. Edhe vetë të akuzuarit në deklaratat e tyre mbi fajësinë eventuale kanë qenë kategorikë se nuk janë përgjegjës për asnjërin prej krimeve që figurojnë në aktakuzë. Paraqitja dhe qëndrimi i katër të akuzuarve të parë ka qenë dinjitoze dhe

me respekt për gjykatën, ndonëse jo edhe për aktakuzën e përpiluar me një optikë dhe shtrembërime të karakterit të luftës së UÇK-së që vjen nga "hetimet", konstruktet dhe propaganda serbe dhe ruse, prej nga edhe i ka marrë si të mirëqena senatori famëkeq zviceran Dick Marti.

"Epoka e re": Çfarë duhet të bëjnë institucionet e Kosovës për t'u dalë në ndihmë këtyre njerëzve?

Maliqi: Sa kam kuptuar, Qeveria e Kosovës është zotuar se do të ofrojë ndihmë materiale dhe juridike për të akuzuarit, dhe kjo është në rregull dhe duhet të bëhet në mënyrë transparente dhe, çfarë është me rëndësi, profesionale për gjetjen e provave që do të ndihmojnë mbrojtjen e të akuzuarave. Nuk do të duhej të

EPOKA E RE **Muhamet KOCI**

Prishtinë, 13 nëntor -
"Epoka e re": Z. Maliqi, këtë javë kemi parë paraqitjen e parë para Dhomave të Specializuara të Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit, të cilët kanë qenë ndër themeluesit e UÇK-së. Cili është komenti juaj për paraqitjen e tyre?

Maliqi: Gjykata Speciale ka

filluar seancat hyrëse dhe procedurale të një procesi që do të zgjasë me muaj, ndoshta edhe vite, varësisht nga numri i rasteve të krimeve që do të shqyrtohen, e aktakuza e prokurorisë përmend se janë njëqind e ca. Më sa mund të vlerësoj nga përmbledhja e aktakuzës që është publikuar me pjesët e provave që tani për tani janë të hequra, të censuruara, procesi është ende në kornizat e raportit të Dick

Martit i cili i ka bërë mu këto akuza për, siç e quan ai, Grupin e Drenicës në Shtabin e Përgjithshëm të UÇK-së, për të cilat thoshte se i ka provat pa i zbardhur ato. Prokuroria e Gjykatës Speciale i ka bërë hetimet tash e sa vite për autorët, rrethanat dhe motivet e këtyre krimeve të luftës, por nëse kihet parasysh se një pjesë e këtyre rasteve janë hetuar dhe gjykuar edhe më herët nga gjykatat e UNMIK-ut dhe



bërë në rikujtimin e krimeve të planifikuara dhe masive të Serbisë dhe këto në dy aspekte, ato të faktuara me rreth 50 masakrat të popullsisë civile ku shumica dërrmuese e tyre nuk janë hetuar dhe gjykuar, edhe nëse urdhëruesit dhe ekzekutorët nuk kanë marrë dënime meritore, por simbolike, në mos dhe janë liruar nga përgjegjësia. Nuk kemi ditur të mbajmë gjallë dhe vazhdimisht kërkujmë dënimin e përgjegjësve të zhvarrosjes të mijëra civilëve të vrarë në Kosovë që janë bartur në varrezat masive në Serbi. Prej tyre janë hapur vetëm disa, më e madhe në Batajnicë, në poligonin e ushtrimit të forcave policore serbe, si një shembull më eklakant i përpjekjeve që të zhduken dëshmitë sipas logjikës së mbrapshtë dhe kriminele: “Nëse nuk ka kufoma, nuk ka krim e as përgjegjësi” Së fundi vetë qarqet kundër regjimit në Serbi kanë zbuluar se menjëherë pas përfundimit të luftës kabineti i kryeministrit Gjingjqi ka qenë i informuar për Batajnicën dhe listën me gjithsejtë 16 varreza masive gjithandej Serbisë ku janë fshehur kufomat e viktimave civile shqiptare! Kjo është një temë makabre e kriminimit të dyfishtë të organizuar nga vetë shteti, së pari ekzekutimet masive, pastaj edhe fshehja e gjurmëve të tyre. Para një muaji Ivica Daçiqiu patë vërsulur me kërcënime denoncuesve serbë të fshehjes së varrezave masive dhe qeveria jonë do të bënte punë të madhe nëse do të bënte një

promemorie ose padi ndaj Daçiqit dhe përgjegjësve të tjerë për krimet masive të luftës që kanë bërë forcat serbe e që kanë mbetur të pahetuara dhe të pandëshkuara. Në sfondin e kriminalizimit të luftës çlirimtare, zbardhja e këtyre krimeve do të riaktualizonte një kontekst tashmë të zbehur të motiveve pse ka qenë e pashmangshme kryengritja e UÇK-së dhe mobilizimi i tërë shoqërisë së Kosovës kundër regjimit serb dhe çlirimit të Kosovës.

“Epoka e re”: Aktakuzën ndaj tyre shumëkush e ka cilësuar si tendencë për ta kriminalizuar luftën e UÇK-së. A po tentohet ndryshimi i historisë përmes kësaj gjykate?

Maliqi: Serbia nacionaliste dhe hegjemoniste vazhdimisht ka shtrembëruar dhe falsifikuar historinë e marrëdhënieve me shqiptarët. Por, nuk besoj se mund të ketë sukses kriminalizimi i luftës së UÇK-së pos, ndoshta, rastet e vrasjeve dhe krimeve të tjera që i liston aktakuza e që deri më sot kanë mbetur të pasqaruara ose me pretendime se janë bërë me motive të liga dhe kriminele. Siç dimë, shumica prej tyre janë hetuar dhe gjykuar edhe më herët dhe ka pasur edhe ndëshkime të atyre që janë përgjegjës, por nuk kanë pasur sukses as Tribunali i Hagës e as gjykatat e UNMIK-ut dhe EULEX-it, që ta dëshmojnë përgjegjësinë komanduese të kreu të UÇK-së, siç po pretendohet me këtë gjykim të sapofilluar. Më duket se

aktakuza aktuale, pas dështimit që të sigurohen provat për tregti të organeve, e as dëshmitë e dokumentuara të planeve të UÇK-së për shfarosje të serbëve dhe pakicave joshqiptare në Kosovë, do të përqendrohet kryesisht në një dosje me kumtesa të Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së që janë publikuar gjatë luftës, ku Shtabi merrte përgjegjësinë për atentatet kundër zyrtarëve serbë si dhe likuidimet e shqiptarëve që dyshoheshin se i shërbenin regjimit serb si kolaboracionist. Mund të ketë edhe zbulime të tjera rreth rasteve që konsiderohen të dënueshme si krime lufte, por nuk besoj se mund të krijojnë platformë të arsyeshme për përgjegjësi komanduese të Shtabit, sepse lufta e UÇK-së ka qenë guerile dhe mjaft disperzive.

“Epoka e re”: Cilat janë pasojat që mund t'i sjellë kjo gjykatë për shtetin e Kosovës?

Maliqi: Shteti i Kosovës, edhe nëse eventualisht ndëshkohen të akuzuarit, nuk mund të ketë pasoja radikale, siç frikësohen disa, sepse shteti nuk mund të zhbëhet dhe të kthehet në gjendjen e para 20 vjetëve.

“Epoka e re”: Në aspektin e brendshëm kemi parë se kjo gjykatë ka lënë Kosovën pa president dhe ka sjellë një përplasje të partnerëve të koalicionit qeverisës. Si duhet të sillen partitë politike në raport me këtë sfidë?

Maliqi: Në kohën e pandemisë partitë politike po sillen në mënyrë krejtësisht të gabuar

dhe pa koordinim substancial që diktohet nga interesi vital i mbrojtjes së shëndetit kombëtar dhe ekonomisë së shtetit dhe kështu po vazhdojnë edhe në raport me gjykimin në Hagë. Mirëpo, besoj se situata do t'i kthjellë shpejt, sepse nuk ka më hapësirë manovruese për konfrontimet që në plan të parë nxjerrin interesat e partive, të grupeve dhe të liderëve të caktuar, e jo ato të përgjithshme.

“Epoka e re”: Tejkalimin e kësaj gjendje, e shihni me zgjerim të koalicionit qeverisës, i cili do të mund ta zgjidhte presidentin e ri, apo me zgjedhje të reja?

Maliqi: Mendoj je zgjidhjet janë të pashmangshme, por jo menjëherë dhe jo as në pjesën e parë të vitit të ardhshëm, jo vetëm për shkak të pandemisë, por edhe duhet një lloj stabilizimi i brendshëm i raporteve. Koalicioni më i gjerë qeverisës do të mund të kontribuonte në këndellje, por me premtim që të mbahen zgjedhjet e reja pasi që të krijohen kushtet më të volitshme. Po kështu, një qeveri më e gjerë na duhet edhe për shkak të dialogut, të cilin nuk duhet ta lëshojmë me fajin tonë ose duke çuar inate. Kjo për arsye se ende ka një fije arsye të besohet se edhe BE-ja dëshiron që të mbyllë dialogun me sukses dhe njohje të ndërsjellë. Duhet të jemi të kujdesshëm në kërkesat për ndërprerjen e dialogut, të paktën derisa nuk kemi një qeveri të re funksionale në ShBA.

bënim kundërpropagandë të thjeshtë, por dekonstruktiv faktografik të propagandës dhe sajësave paragjyquese serbe që luftën çlirimtare të UÇK-së e paraqesin si terrorizëm dhe luftë të motivuar me qëllime fetare. Për gjykatën, por edhe opinionin botëror, ne nuk kemi

Përhapje e madhe e Covidit në Kosovë, 963 raste të reja në 24 orët e fundit

Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës (IKShPK) ka njoftuar se në 24 orët e fundit janë konfirmuar edhe 963 raste të reja me Covid-19 në vendin tonë. IKShPK-ja ka njoftuar se brenda 24 orëve janë raportuar edhe 13 raste të të vdekurve nga ky virus

PRISHTINË, 13 NËNTOR (ER) - Gjatë 24 orëve të fundit në Laboratorin e Mikrobiologjisë Molekulare në Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKShPK) janë testuar gjithsej 2 056 mostra të marra nga Shërbimi Spitalor Klinik Universitar i Kosovës (ShSKUK) dhe gjurmimi i kontakteve të rasteve në terren, prej të cilëve rezultojnë 963 raste pozitive me Covid-19.

Brenda 24 orëve janë raportuar 13 raste të vdekjes me Covid-19. Rastet e vdekjes janë nga komunat: Prishtinë tri raste (88,

67, 64 vjeç), Gjakovë dy raste (85, 83 vjeç), Pejë dy raste (81, 62 vjeç), Prizren dy raste (74, 70 vjeç), Kamenicë një rast (90 vjeç), Podujevë një rast (69 vjeç), Suharekë një rast (60 vjeç), Viti një rast (66 vjeç).

Numri total i rasteve pozitive është 27 851 raste nga 115 794 persona të dyshimtë me këtë virus dhe 797 raste të vdekjes. Gjatë 24 orëve të fundit janë shëruar 177 pacientë, kurse numri i përgjithshëm i të shëruarve deri më sot është gjithsej 16 862 raste, ndërsa numri i rasteve aktive është 10



192. Rastet pozitive janë nga komuna Prishtinë 347 raste, Ferizaj 102 raste, Podujevë 61 raste, Gjakovë 52 raste, Gjilan 51 raste, Fushë-Kosovë 45 raste, Shtime 34 raste,

Prizren 30 raste, Vushtrri 28 raste, Pejë 27 raste, Mitrovicë 24 raste, Lipjan 21 raste, Viti 20 raste, Obiliq 16 raste, Rahovec 16 raste, Kaçanik 12 raste, Suharekë 12 raste, Malishevë 10 raste, Klinë 9

raste, Deçan 8 raste, Kamenicë 8 raste, Drenas 7 raste, Istog 7 raste, Skenderaj 6 raste, Dragash 5 raste, Hani i Elezit 2 raste dhe me nga një rast komunat Graçanicë, Novobërdë dhe Shtërpçë.

Ministri Selimi favorizon arbitrazhin edhe në krahasim me përfitimet e Gjykatës Komerciale

EPOKA E RE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 13 NËNTOR - Gjykata Komerciale përfaqëson një avantazh mjaft të rëndësishëm për fushën e të bërit biznes pasi ofron zgjidhje të kontesteve komerciale pa tejkzgatje të vendimmarrjes ndërinstytucionale, sfidë kjo me të cilën janë ballafaquar bizneset deri më tani. Megjithatë, proces tjetër mjaft favorizues për bizneset është edhe ai i arbitrazhit. Këto u thanë gjatë një forumi virtual të organizuar të premtën nga Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë dhe Programi i USAID-it për Drejtësi Komerciale, me ministrin e Drejtësisë, Selim Selimi.

Ministri i Drejtësisë, Selim Selimi, gjatë këtij diskutimi ka theksuar se tanimë ministria që ai drejton është në fazat përfundimtare për prezantimin e Projektligjit për Gjykatën Komerciale. Ai, po ashtu, ka potencuar se me funksionalizimin e kësaj gjykate po krijohet një shtyllë e re e sistemit të drejtësisë në vend, kurse ka shtuar se nenet dhe

kapitujt që përbëjnë këtë gjykatë do të mjaftojnë për lirin e kapitalit, njëkohësisht do t'i bëjnë më efektive interaksionet në mes të personave qoftë fizikë apo juridikë në zgjidhjen e kontesteve komerciale.

Duke elaboruar më tutje për përmbajtjen e projektligjit, ministri Selimi ka theksuar se Gjykata Komerciale do të përbëjë një adresë të vetme për adresimin e çështjeve komerciale, ndërsa rekomandoi bizneset ta përdorin arbitrazhin si metodë shumë e shpejtë dhe efektive për zgjidhjen e kontesteve.

Vjosa Shkodra, zëvendës-drejtoreshë e Programit të USAID-it për Drejtësi Komerciale, ka potencuar se me implementimin e programit që ajo përfaqëson, ideja dhe qëllimi i themelimit të Gjykatës Komerciale ka qenë në proces e sipër dhe është paraparë në kuadër të rishikimit funksional të sundimit të ligjit.

Duke u ndërlidhur me proceset e kryera drejt themelimit të kësaj gjykate, Shkodra ka përmendur se të drejtat e bizneseve garantojnë me Kushtetutën e vendit ndërsa ka theksuar se,



përveç hapësirave ligjore për trajtimin e çështjeve të caktuara, është adresuar edhe ekzekutimi i vendimeve ose prapësimi i tyre në procedura të përbarmimit kur janë në kontest bizneset.

Më tutje, ajo ka shtuar se për Gjykatën Komerciale është kërkuar një numër më i madh i gjykatësve, gjë që mund të shërbejë për adresimin e njërit

prej problemeve që sistemi gjyqësor ka hasur deri më tani. Jason Emert, arbitër në Qendrën e Arbitrazhit në Odën Amerikane, ka thënë se arbitrazhi dhe Gjykata Komerciale funksionojnë së bashku gjersa ka theksuar edhe përparësitë që arbitrazhi sjell në zgjedhjen e kontesteve komerciale. Duke iu referuar zbatimit të arbitrazhit në Shtetet

e Bashkuara, Emert ka thënë se ka një trend pozitiv në përdorimin e kësaj metode, ndërsa duke u ndërlidhur me veprimtarinë që po bëhet në Kosovë për themelimin e Gjykatës Komerciale, të njëjtën ai e ka cilësuar si shumë të rëndësishme për veprimtarinë dhe fushën e të bërit biznes në vend.

Financimi adekuat i shërbimeve sociale, garanci e mirëqenies sociale



PRISHTINË, 13 NËNTOR (ER) - Instituti Kosovar për Qeverisje Lokale (KLGJ) ka organizuar punëtorinë virtuale me temën "Politikat sociale në nivel lokal". Pjesëmarrës në këtë sesion trajnues ishin përfaqësues të Drejtorive për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale (DSHMS) nga niveli lokal dhe Qendrave për Punë Sociale (QPS).

Qëllim i takimit ishte diskutimi lidhur me financimin e shërbimeve sociale në nivel

lokal, me theks Grantin e Veçantë për Shërbimet Sociale dhe Ligjin për Shërbimet Sociale dhe familjare. "Politikat sociale janë një grup politikash publike që synojnë sigurimin e mbrojtjes dhe mirëqenies sociale si një kërkesë morale dhe politike. Para së gjithash, komunat kanë kompetenca të plota dhe ekskluzive sa i përket interesit lokal, duke i respektuar standardet e përcaktuara në legjislacionin e zbatueshëm për

ofrimin e shërbimeve familjare dhe shërbimeve të tjera të mirëqenies sociale", ka njoftuar Instituti Kosovar për Qeverisje Lokale.

Granti i Veçantë për Shërbimet Sociale shërben për financimin e kostos së ofrimit të shërbimeve sociale në nivel komunal bazuar në standardet minimale. Andaj, kriteret e financimit kanë për qëllim adresimin e problemeve në financimin aktual dhe politikat

e reja në këtë fushë. "Megjithatë, është evidente që institucionet shtetërore duhet të sigurojnë mbështetje të përshtatshme financiare për ofrimin e shërbimeve sociale, pasi kjo paraqet një investim efektiv dhe një element thelbësor për përmirësimin e jetës së qytetarëve. Në këtë aspekt, planet komunale për shërbime sociale, janë instrument i rëndësishëm dhe mund t'i paraprijnë rritjes së koordinimit

dhe efikasitetit në zbatimin e politikave të reja, siç është Granti i Veçantë për Shërbime Sociale, nëpërmjet Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal, Ligjit për Shërbimet Sociale dhe Familjare, si dhe ligjet e tjera që synojnë rregullimin e politikave sociale në Republikën e Kosovës", ka njoftuar KLGJ. Ky aktivitet u realizua në kuadër të platformës "Kosova që duam" me mbështetje të Friedrich Ebert Stiftungut.

Qeveria ndryshon planin legjislativ, tërhiqen disa projektligje



Qeveria e Kosovës në mbledhjen e zhvilluar të premten ka bërë ndryshimin dhe plotësimin e Programit Legjislativ të vitit 2020, sipas të cilit, shtyhet afati i miratimit në qeveri i Projektligjit për Partneritetin Publiko-Privat, Projektligjit për Financat e Pushtetit Lokal, Projektligjit për Lotarinë e Kosovës dhe Projektligjit për Borxhin Publik. Po në këtë mbledhje kabineti qeveritar ka tërhequr edhe disa projektligje

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINE, 13 NËNTOR - Qeveria e Kosovës ka zhvilluar mbledhjen e rregullt të premten, në të cilën ka miratuar projektligje, vendime dhe dokumente të tjera të fushave të përgjegjësisë kushtetuese dhe ligjore. Kabineti qeveritar në këtë mbledhje ka bërë ndryshimin dhe plotësimin e Programit Legjislativ të vitit 2020, sipas të cilit, shtyhet afati i miratimit në qeveri i Projektligjit për Partneritetin Publiko-Privat, Projektligjit për Financat e Pushtetit Lokal, Projektligjit për Lotarinë e Kosovës dhe Projektligjit për Borxhin Publik. Ndërsa tërhiqen nga Programi Legjislativ për vitin 2020 të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe barten për vitin 2021, Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit Doganor dhe të Akcizave; Projektligji për Agjencinë e Tatimeve dhe Doganës; Projektligji për Administratën Tatimore dhe Procedurat; Projektligji për Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare jo Bankare; Projektligji për Tatim në të Ardhurat Personale; dhe Projektligji për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar. Qeveria ka miratuar vendimin për t'i proceduar Kuvendit të Republikës së Kosovës mendimin për nismën

legjislative për Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për statusin dhe të drejtat e dëshmorëve, invalidëve, veteranëve, pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, viktimave civile dhe familjeve të tyre. Në mendimin e Qeverisë thuhet se nisma e propozuar legjislative nuk përcakton periudhën kohore për fillimin e llogaritjes së kontributit për lirin e vendit. Gjendja e krijuar socio-ekonomike nga vështirësitë buxhetore nëpër të cilat është duke kaluar vendi ynë nga pandemia e Covid-19 dhe pasi që nuk është bërë identifikimi i burimeve të financimit për mbulimin e kostos buxhetore, Qeveria e Republikës së Kosovës rekomandon që deri në krijimin e rrethanave të reja më të favorshme buxhetore, një nismë e këtillë ligjore të mos aprovohet nga ana e Kuvendit të Republikës së Kosovës. Miratimin e qeverisë e ka marrë edhe Projektligji për Aktet Juridike. Ky projektligj ka për qëllim përcaktimin e llojeve dhe të hierarkisë së akteve juridike në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Gjithashtu, përcaktohen edhe parimet dhe standardet e hartimit, miratimit, korrigjimit, publikimit dhe zbatimit të akteve juridike. Edhe Projektligji për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për

Agjencinë Kosovare për Krahasimin dhe Verifikimin e Pronës ka marrë miratimin nga qeveria. Ky projektligj adreson të gjeturat e Avokatit të Popullit lidhur me zbatimin e Ligjit për Agjencinë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës si dhe përmbush obligimet e dala nga Strategjia Kombëtare për të drejtat pronësore për adresimin e informalitetit në shkallë të gjerë. Është miratuar edhe Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për letërnjoftimin.

Ndryshimet do t'i përcaktojnë rregullat ligjore të lëshimit të letërnjoftimit, pajisja me letërnjoftim për të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës, organin kompetent, procedurën e lëshimit të letërnjoftimit si dhe përcaktimin e vlefshmërisë së tij. Po në këtë mbledhje të qeverisë është miratuar edhe Rregullorja për metodologjinë

e hartimit të vlerësimit të rrezikshmërisë, sipas së cilës, do të hartohet vlerësimi i rrezikshmërisë së popullatës, të mirave materiale dhe kulturore nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera. Rregullorja përcakton bartësit dhe pjesëmarrësit e hartimit të vlerësimit si dhe procedurat për hartim dhe miratim të këtij vlerësimi.

Tahiri emërohet kryesues i Komisionit Ekzekutiv për reformën në fushën e inspektimeve

Qeveria e Kosovës në mbledhjen e së premtes ka themeluar Komisionin Ekzekutiv për Reformën në Fushën e Inspektimeve, ku kryesues është emëruar zëvendëskryeministri i parë Besnik Tahiri. Ky komision do të koordinojë, t'i drejtojë dhe t'i mbikëqyrë aktivitetet e organeve të ndryshme qeveritare që ndërlidhen me reformën e fushës së inspektimeve si një proces me

interes nacional. "Si kryesues i kësaj reforme do të analizohet nevoja mbi inspektimet, realisht se për cilat dhe çfarë inspektimesh (në cilat fusha) ka nevojë shteti i Kosovës. Reforma në fushën e inspektimeve është e domosdoshme duke përcaktuar fushëveprimin e tyre, selektimin e inspektimeve dhe inspektorateve në një vijë të qartë llogaridhënëse", ka thënë Tahiri.

KOMISIONI EKZEKUTIV PËR REFORMËN NË FUSHËN E INSPEKTIMEVE KA KËTË PËRBËRJE:

Zëvendëskryeministri i parë - kryesues
Ministri i MTI-së - zëvendëskryesues
Ministri i MPB-së - anëtar
Sekretari i Përgjithshëm, MAPL - anëtar
Drejtori i Zyrës për Planifikim Strategjik, ZKM - anëtar
Drejtori i Zyrës Ligjore, ZKM - anëtar
Drejtori i Departamentit Ligjor, MTI - anëtar
Drejtori i Departamentit të Buxhetit, MF - anëtar
Drejtori i Departamentit Ligjor, MAPL - anëtar.



Zyra Kombëtare e Auditimit të Kosovës anëtarësohet në EUROSAI

PRISHTINË, 13 NËNTOR (ER) - Bordi Drejtues i Organizatës Evropiane të Institucioneve Supreme të Auditimit (EUROSAI) në takimin e 52-të ka miratuar me shumicë votash anëtarësimin me të drejta të plota të Zyrës Kombëtare të Auditimit në këtë organizatë. Në një deklaram publik, Auditori i Përgjithshëm i Kosovës, Besnik Osmani, ka falënderuar homologët e tij nga Institucionet Supreme të Auditimit anëtare të Bordit Drejtues për mbështetjen dhe besimin e dhënë si dhe të gjitha institucionet relevante vendore për përkrahjen në këtë proces anëtarësimi. "Zyra

Kombëtare e Auditimit është e përkushtuar ta japë kontributin e vet në këtë organizatë dhe t'i marrë përsipër të gjitha obligimet", ka thënë Osmani. Ky anëtarësim shënon edhe një hap të rëndësishëm në historinë e re të Zyrës Kombëtare të Auditimit si dhe përafrimit në procesin e integritimit në Bashkimin Evropian. ZKA në strukturat e EUROSAI-t do të promovojë, përveç të tjerash, qeverisjen e mirë, rritjen e transparencës dhe llogaridhënies si dhe ngritjen e kompetencës profesionale në fushën e auditimit publik.



EUROSAI është një nga Grupet Rajonale të Organizatës Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (INTOSAI) e cila u krijua në vitin 1990 dhe atëherë kishte 30 anëtarë,

Institucione Supreme të Auditimit të 29 shteteve evropiane dhe Gjykata Evropiane e Auditorëve. Ndër vite numri i anëtarëve të EUROSAI-t ka arritur në pesëdhjetë, ndërsa Zyra Kombëtare e Auditimit të Republikës së Kosovës është anëtarë më i ri, i 51-ti me radhë. Zyra Kombëtare e Auditimit kishte aplikuar për anëtarësim në EUROSAI më 24 shkurt 2020, ndërsa shqyrtimi i vendimit për anëtarësim ishte vendosur në agjendën e takimit të Bordit Drejtues të EUROSAI-t, i planifikuar të mbahej në qershor 2020.

ATK-ja dhe Dogana rrisin bashkëpunimin



PRISHTINË, 13 NËNTOR (ER) - Ushtruesi i detyrës së drejtorit të përgjithshëm të ATK-së, Ekrem Hysenaj, me bashkëpunëtorë, ka takuar ushtruesin e detyrës së drejtorit të përgjithshëm të Doganës së Kosovës, Bajram Rexhen dhe bashkëpunëtorët e tij, me të cilët kanë diskutuar për temat të cilat ndërlidhen me aktivitetet e dy institucioneve. Ndër pikat kryesore të cilat u

diskutuan, me theks të veçantë ishte ajo për planin e mbikëqyrjes për vendimet e lirimeve, si dhe angazhimet e përbashkëta për zbatimin e strategjisë për luftimin e ekonomisë joformale. Për pikën e parë u morën vesh që deri në fund të këtij viti të shtohen kontrollet nëpërmjet njësive të përbashkëta, fillimisht si fushë e parë me risk të lartë u

identifikuan kontrollet e lirimeve nga akciza për burimet e energjisë (gazit, naftës etj.), si dhe lirimet nga taksa doganore dhe më pas gradualisht edhe kontrollet e tjera të mallrave të liruara. Ndërsa te pjesa e luftimit dhe parandalimit të ekonomisë joformale diskutuan për njësitet respektive për zbatimin e strategjisë, sipas planit të

veprimit, i cili ka të identifikuar sektorët të cilët paraqesin risk të lartë. Të dy drejtorët e institucioneve kyçe për mbledhjen e të hyrave për vendin u morën vesh të vazhdohet shtimi i bashkëpunimit edhe në fusha të tjera, të cilat konsiderohen të rëndësishme për të dyja agjencitë. Ndër të tjera, potencuan se efikasiteti dhe angazhimi i pandërprerë

janë mënyrat e vetme të cilat kontribuojnë drejtpërdrejt për ndërtimin e shtetit, njëherësh për ngritjen e standardeve jetësore të popullit të Kosovës, veçanërisht në këtë periudhë ku jo vetëm vendi ynë po ballafaqohet me rrethanat e krijuara nga pandemia Covid-19, e cila në vazhdimësi është duke goditur mjaft rëndë sektorin e ekonomisë.

Hoti dhe Ajdini pajtohen të finalizohet Kontrata Kolektive Nacionale

PRISHTINË, 13 NËNTOR (ER) - Kryeministri i Kosovës, Avdullah Hoti, ka pritur të premten në takim kryetarin e Bashkimit të Sindikatave të Pavarura të Kosovës (BSPK), Avni Ajdini. Kryeministri Hoti dhe Ajdini biseduan për gjendjen e punëtorëve në vend dhe u pajtuan që sa më parë të

finalizohet Kontrata Kolektive Nacionale. Drafti i kësaj kontrate është diskutuar në Këshillin Ekonomik Fiskal, mekanizëm përmes të cilit promovohet dialogu social në vend, por mbetet të diskutohen edhe modalitetet e tjera që ndërlidhen me kohën e fillimit të zbatimit të kësaj

marrëveshjeje për shkak të kostos buxhetore dhe situatës së krijuar me pandeminë Covid-19. Kryeministri Hoti e ka nxitur kryetarin e BSPK-së, Ajdini, që ta vazhdojë angazhimin për mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave të punëtorëve, sigurinë dhe shëndetin në punë, në përputhje me ligjet në fuqi.



Qeveria ndan 1.1 milion euro për 'Trepçën'



“Qeveria do të ndajë 1.1 milion euro për ndërmarrjen ‘Trepça’ për ta tejkaluar situatën nëpër të cilën po kalon. Bordi do të ofrojë garancitë e veta përmes planit të biznesit që duhet të dorëzohet shpejt në Ministrinë e Ekonomisë dhe Ambientit për mënyrën e menaxhimit të kompanisë në të ardhmen dhe në këtë plan biznesi do të jenë veprimet konkrete që do të ndërmerren nga bordi i kompanisë karshi menaxhmentit të kompanisë për t’u siguruar që kompania nuk vjen prapë në këtë situatë”, ka thënë kryeministri Avdullah Hoti në një konferencë për media

ftuar në këtë konferencë për shkak të rëndësisë së informatës, të cilën dëshirojmë ta dërgojmë te qytetarët, minatorët e ‘Trepçës’ në veçanti. Ministri Blerim Kuçi është marrë disa ditë me këtë çështje, me Bordin e ‘Trepçës’, për të tejkaluar situatën në të cilën jemi. Pas shumë diskutimeve, edhe me Ministrinë e Financave, sot e kemi ftuar edhe Bordin e përkohshëm të ‘Trepçës’ për t’u marrë vesh për hapat që duhet të ndërmerren në ditët e ardhshme, për të tejkaluar situatën në ‘Trepçë’. Situata në kompani është vërtet shumë e vështirë, por është e vështirë, pjesërisht për shkak të gjendjes nëpër të cilën po kalojmë, të pandemisë në nivel global dhe për shkak të pamundësisë që ‘Trepça’ t’i shesë produktet e saj në tregje botërore për shkak të rënies së çmimeve në berëz. Por,

pjesërisht duhet pranuar faktin se është edhe për shkak të menaxhmentit joadekuat dhe joefikas për menaxhimin e kësaj kompanie”, ka thënë Hoti.

Ai ka shtuar se këtë kompani vit pas viti e subvencionojnë sa iu përket investimeve kapitale në një shumë të konsiderueshme që shkon rreth 7 milionë euro por, pavarësisht kësaj, Hoti ka thënë se në këtë situatë, në të cilën gjendet tash “Trepça” është dashur të bëjnë një zgjidhje të përkohshme bashkë me Bordin e “Trepçës” për ta tejkaluar situatën dhe për t’i mundësuar kësaj kompanie operimin më tutje. “Qeveria do të ndajë 1.1 milion euro për ndërmarrjen ‘Trepça’ për ta tejkaluar situatën nëpër të cilën po kalon. Bordi do të ofrojë garancitë e veta përmes planit të biznesit që duhet të dorëzohet shpejt në Ministrinë e Ekonomisë dhe Ambientit për

mënyrën e menaxhimit të kompanisë në të ardhmen dhe në këtë plan biznesi do të jenë veprimet konkrete që do të ndërmerren nga bordi i kompanisë karshi menaxhmentit të kompanisë për t’u siguruar që kompania nuk vjen prapë në këtë situatë”, ka thënë kryeministri Hoti, duke shtuar se kjo ndihmë që qeveria jep me taksat e qytetarëve për minatorët dhe për ndërmarrjen “Trepça” do të mundësojë që ta tejkalojë këtë situatë të tillë. “Në plot ndërmarrje të tjera kemi probleme pak a shumë të ngjashme, por për shkak të specifikave që ka ndërmarrja ‘Trepça’, me insistimin e ministrit, e kemi trajtuar pak më ndryshe këtë çështje dhe bashkë me ministrin e Financave besoj se është gjetur zgjidhja më e mirë e mundshme në rrethanat në të cilat jemi”, ka deklaruar Hoti.

EPOKA
ERE **Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINË, 13 NËNTOR - Kryeministri i Republikës së Kosovës, Avdullah Hoti, së bashku me ministrin e Ekonomisë dhe Ambientit,

Blerim Kuçi, zëvendësministrin e Financave, Agim Krasniqi, si dhe përfaqësuesit e Bordit të Përkohshëm të “Trepçës”, mbajti një konferencë për media të premten, në të cilën bëri me dije ndarjen e 1.1 milion eurove për ndërmarrjen “Trepça”. “Ju kemi

Naser Krasniqi emërohet kryeshef i AUV-it

Prishtinë, 13 nëntor (ER) - Qeveria e Kosovës ka ndryshuar dhe plotësuar vendimin për emërimin e anëtarëve të Bordit Drejtues të

Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinës (AUV). Sipas këtij ndryshimi, në vend të Valdet Gjinovcit, kryeshef i kësaj agjencie është emëruar Naser

Krasniqi. Përveç vendimit për anëtarë të bordit, është miratuar edhe vendimi për emërimin e anëtarëve të Këshillit Shkencor të

Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë, ku në vend të Imer Hazirit është emëruar Rreze Gecaj nga Fakulteti i Bujqërisë dhe Veterinarisë.



Komuna e Gjakovës, bashkë me KRM 'Çabrati', shpërndajnë komposterë shtëpiakë

GJAKOVË, 13 NËNTOR (ER) - Komuna e Gjakovës, në bashkëpunim me KRM "Çabrati", ka filluar shpërndarjen e komposterëve shtëpiakë. Kjo shpërndarje e komposterëve po bëhet në kuadër të projektit "Kompostimi shtëpiak" në bashkëpunim me Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH dhe organizatën joqeveritare Green Art Center-Prishtina (GAC).

Gjatë lansimit të projektit në

lagjen e Çabratit, Albana Hana Bakalli, udhëheqëse e sektorit për Menaxhimin e Mbeturinave, tregoi se janë gjithsej 266 komposterë të cilët shërbejnë për grumbullimin e mbeturinave organike. "Të njëjtat pas gjashtë muajsh shndërrohen në pleh organik, proces ky i rëndësishëm për një ambient të pastër. Shpërndarja do të vazhdojë në Bllokun e Ri, fshatin Dobrixhe dhe atë Pjetërshan", ka njoftuar Komuna e Gjakovës.



'Ekoregjioni' pranon donacion 15 kamionë nga Qeveria e Japonisë



PRIZREN, 13 NËNTOR (ER) - Kompania "Ekoregjioni" për rajonin e Prizrenit ka pranuar 15 kamionë donacion nga Qeveria e Japonisë. Këta kamionë do të përdoren për

grumbullimin e mbeturinave. Lajmin e ka bërë me dije kryesuesi i Bordit të "Ekoregjionit", Bujar Dakaj, në rrjetin social "Facebook". "Këto automjete do të

shfrytëzohen për njësitë e Ekoregjionit në Malishevë, Dragash, Suharekë dhe Rahovec. Unë si kryesues i Bordit të Ekoregjionit u jam shumë falënderues dhe

Komuna e Skenderajt furnizon me shporta të mbeturinave fshatin Kuçicë

Skenderaj, 13 nëntor (ER) - Drejtorja e Shërbimeve Publike në Komunën e Skenderajt, në bashkëpunim me "Unitetin", kanë vazhduar furnizimin me shporta të mbeturinave për të gjitha ekonomitë familjare në fshatin Kuçicë. Deri në fund të këtij viti do të pajisen me shporta 1 000 familje në 11

fshatra të Komunës së Skenderajt. "Ky projekt për pajisjen me shporta grumbulluese të mbeturinave do të vazhdojë edhe vitin e ardhshëm në lokacione të tjera qytetit tonë, duke përfshirë të gjitha vendbanimet e territorit të Skenderajt", ka njoftuar Komuna e Skenderajt.



Arrestohet një person i dyshuar që transportonte municion

MITROVICË, 13 NËNTOR (ER) - Policia në Mitrovicë, gjatë kontrollit të një veture, ka gjetur dhe ka sekuestruar 1 200 fishekë të armës së gjuetisë. I dyshuari L. F., 46 vjeç, është shoqëruar në stacionin policor dhe me urdhër të gjykatës është kryer

edhe bastisja e shtëpisë së personit në fjalë, ku si prova materiale janë gjetur dhe janë sekuestruar: një pistoletë 'Bereta', një karikator dhe 10 fishekë 9 mm. Pas procedurave intervistuese, me urdhër të prokurorit kujdestar, të

dyshuarit L. F., 46 vjeç, i është shqiptuar masa në mbajtje 48 orë dhe ndaj tij është iniciuar rasti për "import, eksport, furnizim, transport, prodhim, këmbim, ndërmjetësim ose shitje e paautorizuar e armëve apo materialeve plasëse".



Nisin punimet për asfaltimin e rrugës për te varrezat e qytetit në Junik

JUNIK, 13 NËNTOR (ER) - Komuna e Junikut ka filluar punimet dhe është në fazën përgatitore për asfaltimin e rrugës për te varrezat e qytetit.

Projekti ka për qëllim evitimin e varrezave nëpër lagje dhe afër zonave të banueshme, projekt i zhvilluar sipas standardeve ndërkombëtare

që siguron të gjitha kushtet infrastrukturore dhe mirëmbajtjen e tyre. Projekti financohet nga Komuna e Junikut.

Reagim i KMDLNj-së

Mashtrimi publik i Ekaterina Trandafilovës nga Gjykata Speciale njëetnike!



Senatori zviceran Dick Marty, me përkrahje logjistike dhe materiale të Serbisë dhe Rusisë, e bëri publik një raport politik për krimet e pretenduara të UÇK-së gjatë dhe pas luftës në Kosovë, me theks të veçantë e përmendi Shtëpinë e Verdhë në Burrel, Shqipëri që paska shërbyer si spital për heqje dhe trafikim të organeve të civilëve të rrëmbyer serbë dhe romë e që ishin prurë nga Kosova në Shqipëri. Këto krime të pretenduara fillimisht përfshinin kohën pas përfundimit të luftës e deri në përfundim të vitit 2000. Në bazë të këtij raporti, Këshilli i Evropës votoi themelimin e një Task Force për hulumtimin e këtyre pretendimeve në me krye prokurorin amerikan, Williamson. Në raportin e Dick Martyt listoheshin të dyshuarit për krime lufte dhe krime kundër njerëzimit, të gjithë shqiptarë dhe të gjithë udhëheqës apo ushtarë të UÇK-së. Në bazë të këtij raporti, deputetët e Kuvendit të Kosovës, në rrethana të shantazhimit, kërcënimit dhe terrorizimit psikik u detyruan (përfshijtur një numri të deputetëve të opozitës dhe pozitës) ta votojnë Ligjin për formimin e një Gjykate Speciale të Kosovës, me seli në Hagë!!! Paraprakisht e ndryshuan edhe Kushtetutën e Kosovës duke ia kaluar të gjitha kompetencat kësaj gjykate dhe duke mos e identifikuar me asgjë me sistemin e drejtësisë të Kosovës pjesë e së cilës mendohej të ishte kjo gjykatë. Të gjitha marrëveshjet që u nënshkruan midis Kosovës, Holandës (ku është selia e Gjykatës Speciale njëetnike) ishin kundër Kosovës duke e zhveshur Kosovën nga pronësia qoftë edhe simbolike mbi këtë gjykatë e cila paraqet nonsens të llojit të vet dhe në kundërshtim me të gjitha praktikatat e gjykatave ndërkombëtare për krime lufte të formuara deri më tani. Shumica e gjykatësve, prokurorëve, hetuesve, policëve apo administratës ishin mbetje e Tribunalit të Hagës për Krime Lufte për ish-Jugosllavinë, të UNMIK-ut, EULEX-it dhe Task Forcave që bënin eksperimente

gjatë mandatit të tyre në Kosovë. Ekaterina Trandafilova u zgjodh kryetare e kësaj Gjykate Speciale njëetnike dhe, në të gjitha paraqitjet publike kurrë nuk përmendi krimet e Serbisë të kryera në Kosovë por tërë kohën është deklaruar për raportin e Dick Martyt, si alfa dhe omega e angazhimit të saj duke demonstruar një qasje krejtësisht diskriminuese dhe në kundërshtim me të drejtat e njeriut, si vlera universale dhe të pandashme. Pastaj u formua e ashtuquajtura Gjykata Kushtetuese e Gjykatës Speciale njëetnike e që nuk ka ndodhur me asnjë Gjykatë për Krime Lufte, që nga ajo e Njrembergut e deri te kjo e Dick Marty. Që ironia të jetë edhe më e madhe, u themelua edhe Institucioni i Ombudspersonit - Avokatit të Popullit i cili nuk ka bërë asnjë veprim në mbrojtje të interesave të personave të privuar nga liria, që të gjithë shqiptarë, as në rast se kur janë ftuar nga kjo Gjykatë pa i treguar në çfarë cilësie ftohen, pa vendim të shkruar, as kur Gjykata Speciale njëetnike ka kërkuar që të ftuarit të sjellin me vete prova fajësuese kundër tyre e që këtë e ka rrëzuar avokati nga Kosova, Artan Qerkini pasi e ke denoncuar si shkelje të rëndë të Rregullores së kësaj gjykate dhe të drejtave të njeriut të të ftuarve. Në të gjitha gjykatat në botë gjatë leximit të të drejtave të personave të dyshuar apo të akuzuar, gjykatësi i procedurës paraprake, ndër të tjera ua njofton të drejtën të mos flasin asgjë që i ngarkon të dyshuarit e lëre më të sjellin materiale vetakuzuese apo akuzuese për të

tjerët siç kërkonte më parë kjo gjykatë. I ashtuquajtura Avokat i Popullit asnjëherë nuk ka reaguar kur të dyshuarve apo të akuzuarve iu është shkelur e drejta kushtetuese për përdorimin e gjuhëve zyrtare në Kosovë e as në rastin kur konfirmimi i aktakuzës është dorëzuar në anglisht ndonëse kjo gjuhë nuk është gjuhë zyrtare në Kosovë. Alter Ego e Prokurorisë së Specializuar i shpërfaqur si Avokat i Popullit nuk ka reaguar fare kur paramilitarët e Speciales dhe policët e EULEX-it kanë ndërhyrë brutalisht në shtëpinë e Jakup Krasniqit duke e mbajtur të prangosur 10 orë dhe duke e marrë në pyetje ndonëse në asnjë praktikë ndërkombëtare nuk parashihet që atij që i konfirmohet aktakuza mund t'i bastiset shtëpia apo të merret në pyetje për dyshimet e konfirmuara, pasi është ngritur aktakuza. Po në këtë mënyrë janë bërë bastisjet në shtëpitë e Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit, Salih Mustafës dhe disa herë është dhunuar selia e veteranëve të OVL-së së UÇK-së dhe janë arrestuar udhëheqësit e kësaj organizate, Nasim Haradinaj dhe Hysni Gucati ndonëse kjo nuk është mandat i kësaj gjykate. Dhe shumë shkelje tjera ligjore dhe të drejtave të njeriut ndaj të cilave i ashtuquajtura Avokat i Popullit bëhet i verbër dhe i shurdhër. KMDLNj, që nga fillimi ka kundërshtuar formimin e kësaj Gjykate Speciale, si nga forma e në veçanti nga përmbajtja për faktin se diskriminon 97 për qind të viktimave (shqiptarë dhe

joserbe) sikur që amnistion 97 për qind të atyre që kanë kryer krime lufte, krime kundër njerëzimit dhe gjenocid në Kosovë. KMDLNj, që nga përfundimi i luftës në asnjë rast nuk i ka ndarë viktimat në baza etnike e as ata që kanë kryer krime duke kërkuar drejtësi për të gjitha viktimat dhe përgjegjësi për të gjithë ata që iu dëshmohet krimi. Gjykata Speciale njëetnike e bënë krejtësisht të kundërtën që e bënë dhe kërkon KMDLNj, bënë diskriminim flagrant në baza etnike. Pas arrestimeve të bujshme kohëve të fundit në Kosovë ku të gjithë të arrestuarit dhe të akuzuarit janë shqiptarë dhe asnjëri nuk është serb, filluan reagimet edhe të ndërkombëtarëve si: Serwer, Eliot Engel dhe të tjerë që denoncojnë karakterin njëetnik të kësaj Gjykate Speciale Njëetnike e që është në harmoni të plotë me qëndrimet e KMDLNj-së. Për të amortizuar këtë kundërshtim e që ka mundësi reale të rritet duke kërkuar riformatimin e kësaj Gjykate Speciale njëetnike, kryetarja e saj, Ekaterina Trandafilova, si karafil i vonuar del se; kjo gjykatë nuk do të dënojë vetëm shqiptarë por të gjithë ata që kanë kryer krime ndonëse e ka të qartë se kjo gjykatë nuk ka juridiksion as në Shqipëri, as në Maqedoni të Veriut e në Serbi nuk kanë guxim ta paraqesin as si ide. Deklarimi i Ekaterina Trandafilovës është vetëm një tymb mashtrues dhe përpjekje për të amortizuar kundërshtimin

e drejtë e ndarjes së drejtësisë sipas parimit etnik, si nga ndërkombëtarët ashtu edhe nga vendorët e që mund të zgjerohet me pasoja jo të favorshme për institucionin diskriminues në krye të së cilës është Trandafilova. Është vetëm një hallkë e mashtrimit, jotransparencës në zinxhirin e këtij konstrukti represiv ndaj një etnie, shqiptarëve, dhe karrot (pa asnjë shkop) për ata që kanë bërë gjenocid në Kosovë e që është Serbia e në disa raste edhe Mali i Zi. Deri më tani ky zinxhir fillon me mashtruesin Dick Marty dhe përfundon me mashtruesen Ekaterina Trandafilova.

KMDLNj do t'i besonte kryetares së Gjykatës Speciale njëetnike se e ka seriozisht në rast kur paramilitarët e Speciales dhe policët e EULEX-it do të arrestonin në Serbi paramilitarët e Arkanit, Sheshelit, të Frenkit apo të tjerët, kur do të arrestoheshin në Serbi kriminelët e luftës Aleksandar Vuçiq, Ivica Daçiç, Dikoviç dhe të tjerët dhe kur do të bastiseshin shtëpitë e tyre sikur që ndodhi në Kosovë dhe duarlidhur dhe këmbëlidhur si rasti i Jakup Krasniqit të dërgohen në Hagë. Gjithashtu, KMDLNj do t'i besonte drejtueses si një mekanizmi të inkuizicionit "demokratik" nëse këta i hapin me dhjetëra varreza masive të mbjella në territorin e Serbisë ku janë varrosur shqiptarët e ekzekutuar në Kosovë apo ata që janë marrë si robër lufte në Serbi e pastaj janë ekzekutuar në Batajnicë dhe batajnicat e tjera. KMDLNj do t'i besonte kësaj Gjykate Speciale njëetnike e që sipas të drejtave të njeriut lirisht mund të konsiderohet edhe raciste në rast se e zbardhë fatin e personave të pagjetur mbi 1,600 (të të gjitha etnive). Në të kundërtën, deklarata e Ekaterina Trandafilovës do të konsiderohet si mashtrim dhe gënjeshtëri e radhës nga kjo gjykatë që ka filluar me Dick Marty e nuk dihet me kënd do të përfundojë. Drejtësia nuk kërkon improvizime por fakte! Drejtësia është shpagim për viktimat dhe familjet e tyre dhe parandalim për krimet në të ardhmin kurse, falja e krimeve të luftës, krimeve kundër njerëzimit dhe gjenocidit që i bëhet Serbisë pashmangshëm krijon kushte për përsëritjen e gjenocidit e që e bëri të qartë edhe kriminelit i luftës dhe i paqes, Aleksandar Vuçiq, kryetar i Serbisë!





Ismail Arslani lindi në Tetovë, më 10 shtator 1947. Ka kryer Fakultetin Filologjik, dega Gjuhë dhe Letërsi Shqipe, si dhe Artin Figurativ në Akademinë Pedagogjike në Shkup. Me profesion është gazetar. Ka punuar në më shumë gazeta dhe redaksi në vend dhe jashtë. Ka qenë redaktor i gazetës javore "Polloga" (1973-1976), gazetar-korrespondent i "Rilindjes" (1976-2001) dhe asaj "Koha Ditore" (2001-2003) të Prishtinës, gazetar-koordinator i "Flakës" (2003-2004) dhe gazetar-redaktor i "Lajmit" (2005-2006). prej vitit 2011, bashkëpunon me gazetën KOHA në Shkupit. Shkrimet publistike i janë botuar edhe në disa media të tjera në Maqedoni, Kosovë, Shqipëri dhe diasporë. Deri më tash ka botuar librat publistikë: "Ditëndori tetovar" (2008), "Përthyerjet politike" (2013), "Vikendat e monismë" (2015) dhe "Tetova në dozat e kohës" (2018). Libri më i ri, "Pushtetarët e mjegullnajës" (2020), është i postit me radhë. Për vepriertari publistikë dhe veprë jousore ka marrë dy herë plaketa nga Këshilli i Komarës së Tetovës (në vitin 2013 dhe 2015), si dhe mirënjohje të tjera nga disa institucione, shoqata dhe asociacione joqeveritare.

Ismail Arslani * PUSHTETARËT E MJEGULLNAJËS

Ismail Arslani

PUSHTETARËT E MJEGULLNAJËS



'Pushtetarët e mjegullnajës', një libër që pasuron mendimin politik shqiptar



Lulëzim ETEMAJ

Publicisti tetovar Ismail Arslani botoi këto ditë në "Shtypin akademik" në Shkup librin më të ri "Pushtetarët e mjegullnajës". Në recensionin që për të e ka bërë profesor Xhelal Zejneli, nënvizohet se Ismail Arslani është autor i disa librave që tashmë konsiderohen pjesë e pashkëputshme e mendimit politik shqiptar në Maqedoninë e Veriut.

Në librin më të ri autori fokusohet në zhvillimet dramatike në këtë vend, duke përfshirë periudhën e viteve 2009-2019. Në këtë përmbledhje shkrimesh kritike autori na paraqitet jo vetëm si pasqyrues i ngjarjeve, por edhe si analist politik, si studiues i

procese, për të cilat e shfaq edhe vizionin e tij. Trajtimi si dhe pasqyrimi në mënyrë të thuktë dhe objektive që ai iu bën zhvillimeve politike si dhe degradimeve të ndryshme në rrafshin etik, e bën librin më të pasur në aspektin shumëdimensional. Gjatë analizimit të marrëdhënieve ndëretnike në Maqedoninë e Veriut, autori iu ka kushtuar një vëmendje të veçantë raporteve midis dy bashkësive etnike më të mëdha në këtë shtet - shqiptare dhe maqedonase. Mbi këtë bazë ai paralajmëron se pa zgjidhjen e drejtë të çështjes shqiptare, Maqedonia e Veriut kurrë s'ka për të qenë shtet i qëndrueshëm dhe i konsoliduar. Zgjidhja e statusit politik dhe juridik të shqiptarëve, sipas pikëpamjeve të autorit, është conditio sine qua non për një Maqedoni demokratike dhe me perspektivë euro-atlantike. Njëkohësisht ai nuk ngurron ta shfaqë me shqetësim konstatimin e arritur, se shqiptarët nuk do t'i realizojnë të drejtat e veta themelore.


Në këtë vazhdë, projektet antishqiptare të qarqeve shoviniste maqedonase, të ndërtaura mbi ideologjinë anakronike dhe retrograde garashaniniste dhe çubrilloviqiste, rrezikojnë ta çojnë Maqedoninë e Veriut në zhbërje. Përmes librit më të ri, "Pushtetarët e mjegullnajës", autori Ismail Arslani paralajmëron po ashtu me shqetësim se shteti demokratik nuk mund të ndërtohet me fjalë, shprehje dhe veprime degraduese ndaj shqiptarëve, të cilët përbëjnë një të tretën e popullsisë së këtij vendi. Fryerjet ndaj tyre, flasin qartë për frymën që ka mbizotëruar në këtë vend, konstaton autori. Sipas pikëpamjes së tij, kjo frymë prezente antishqiptare, nuk ka lindur rastësisht. Ajo është pjellë dhe produkt i politikës së shtetit, i ideologjive të perënduara dhe i inteligjencias maqedonase që nuk ia del të shpëputet nga terri bizantin për të marrë rrugën që shpie drejt familjes perëndimore. Në funksion të paravajtjes së tillë, ai i sugjeron faktorit politik shqiptar që, në funksion të paqes dhe të qëndrueshmërisë së vendit, të veprojë pareshtur që shqiptarët

të fitojnë statusin meritore të popullit shtetformues në përputhje me potencialin e tyre demografik, intelektual, ekonomik, prodhues, krijues dhe mbrojtës.

Përmes këtij libri, autori Arslani e ridëshmon faksin se ai nuk është vëzhgues pasiv i proceseve dhe regjistruer i thjeshtë i tyre. Prandaj, nuk ngurron të shfaq pikëpamjet dhe sugjeron edhe mënyrat konkrete të veprimit politik, si dhe objektivat që duhen arritur. Në fokusin e kritikës së tij e vë edhe inteligjencien shqiptare e cila, për të ruajtur interesat personale, mban qëndrime oportuniste dhe konformiste ndaj subjekteve politike. Në shënjestër të kritikës së tij gjenden poashtu edhe poltronët e partive politike, qëllimi i vetëm i të cilëve është përfitimi vetjak, në dëm të interesit të përgjithshëm. Sipas autorit, marrëdhëniet ndëretnike do të rregullohen atëherë kur shqiptarët të fitojnë statusin e popullit shtetformues. Pa zgjidhjen e mosmarrëveshjeve ndëretnike dhe pa integrimin në organizmat euro-atlantikë, Maqedonia e Veriut nuk do të

mund të konsolidohet si shtet i qëndrueshëm dhe demokratik. Për realizimin e këtyre objektivave, autori sugjeron veprime politike me mjete paqësore dhe demokratike. Është për veprime politike në kuadër të institucioneve të sistemit. Pjesë të demokracisë e konsideron edhe prishjen e koalicioneve qeveritare dhe daljet nga qeveritë. Ai angazhohet për një Maqedoni, me shqiptarët popull shtetformues, për kultivimin e marrëdhënieve ndëretnike, për bashkëjetesën midis etnitetëve, për marrëdhënie të mira me fqinjët dhe për integrimin në strukturat perëndimore. E konsideron si tejet të rëndësishme luftën kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar në shoqëri, duke përfshirë edhe majat e shtetit. Bën thirrje për ndërtimin e shtetit ligjor, për medime të pavarura, për afirmimin e mendimit kritik, të kritikës së lirë politike dhe të asaj shoqërore. Pavarësisht faktit se trajton çështje të politikës ditore, shkrimet e Ismail Arslanit kanë bazë të fuqishme kombëtare dhe demokratike.

Duejeni atdheun për me dashtë vetën!



Nga Çun LAJÇI

Kapedani Gjon Marka Gjoni m'erdhi vonë, mbasi m'kishte nuanë gjumi tue i shfletua kujtimet e hershme. Shihej se dje m'kishte rrokotelë bjeshkëve t'vetmueme Rugova! Unë vetëm i hapa sytë! Trupi nisi m'u dridhë e djersët m'u torolangë ballit. Çka don ky n'Drelaj? Thashë e buzët mu ngjitën njena me tjetrën prej shkrumit! Unë me Galën dola n'Rugovë. Kush s'na pau as kend se pamë, pos do fotografive t'gëdhenduna n'gurë vorrësh. Si asht e mundun t'jemi futë n'shtatë bajraqët e Pukës?! N'mbretinë e Mirditës ç'dreji na pruni, që m'del natën Gjon Marka Gjoni?! E kërkova me sy time shoqe, me i thanë pse erdhëm? Qyshë erdhem? Çka deshtëm grykës Fanit, kur na e kemi Grykën e Rugovës!? Kur që, ajo e kishte veshë xhubletën e vu shaminë e zezë! Dy thasë i kishte mbushë qymyr e po mundohej me i vu n'samarë t'kalit. Eu i thashë vetës, kqyre malësorën e bukur t'Migjenit! Po u bajka gati me ra n'Shkodër me shitë qymyr! U mundova me folë. Dojsha me i thanë, a muj me ba një fotografi me ty, që t'i regjoj Leartit kur t'k-

thelna n'Prishtinë. Veç ta sheh djali im se sa t'bukura janë malësoret e zhigueme me qymyr! Jo, mos iu afro thashë, se kujton mos po lypi diçka tjetër, si ata zotnitë e Shkodrës kur ia blejnë qymyrin! Veç lute a ban kuferin me libra me vu n'ulluk ndërmjet thasve e bashkë m'u zhdjergë të Kafja e Madhe n'Shkodër. Unë me i ra sharkisë e t'i me knua pukjançe! Ndoshta na shitet ma kollaj malli! Unë i habitun mbas malësore e kisha pasë harrua Kapedanin n'kalin zekan, pullali, me kobure n'brez. N'veti m'ktheu roja i tij kur m'i ra krevetit me kundak pushke. Sa i marr je artist, bërtiti Gjoni. Shkruen për hijet tona e komandantët t'i kanë marrë n'burg ata që i ndihmuen n'luftë! Prit Gjoni Marka Gjon, se natën nuk i shkohet malsorit të dera si ujk, se kërset pushka, dhe brofa n'kambë! Nji rrapëllimë u ndëgjua koridorit! Andërr e bukur! Ti ankh i marrë i frikshëm, pse ike, pse ma more andrën kur m'duhej mendimi i Kapedanit?! Gjon Marka Gjoni do t'me tregonte për fundin e komandantëve, se ai asht djegë e pjekë me tradhëtinë e t'huejit e t'vllaut. Ai diçka deshti me m'thanë se tanë at rrugë kot s'e bani n'zekanin pullali! A thua i shkoi n'vesh edhe atij kërcnimi i Vuçitit?! A mos erdh me m'thanë se ata do t'vinë deri të Ibri po rrini gati! U ktheva n'krahun tjetër mbasi e fshina ballin e djersitun e si fletët e librit e shfletova kujtesën e nji sisemi t'vjetër, t'kohës që s'përseriet, t'gjeneratave që nuk ngjallën ma!

Iku Gjon Marka Gjoni pa m'folë e n'harresë gjeta artistë, poetë, shkrimtarë, sportistë, piktorë, kompozitorë, shkenctarë e ç'nuk gjeta ndër ata të ndritun që kombin ma banë t'vezulloi n'der gjashtë republikat Jugosllave! I putha emnat e tyne e kujtesës time t'plakun i fola: E sheh kush ishim e ç'emën patëm! Ani pse shtypëshim e dergjeshim, ne si krojet rrjedhshim damarve t'atdheut e derdhëshim n' luget e Prishtinës. Pastaj shpërndahehim si rrajët tokave t'hueja e krijoshim vepra e nami i rritej kombit, ani pse kurrë s'na thirrën ndryshe pos "shipca"! S'di Bekimin a guxuen ta thërrinin kështu kur dilte n'skenën e Beogradit!

I vriste emni shqiptar e dia jonë e hollë! Por ne nuk ndaleshim, e ndërtojshim t'ardhmën pa ndihmen e kurkujt tue i vra edhe andrrat tona! Ne ditëm e mujtem e bamë edhe pse ishim t'rrudhun e t'robnuem e prore n'dhambin e ujkut. Ajo die ishte etja për vepra t'mira, si ajo e shqiptarit inxhinjerit t'ri nga Martinajt qe e projektoi Hotel Sheherzadën n'Pazarin e Ri, objektin ma t'mirë t'kohës se tij? Imer Balidemaj ishte, malësori i shkolluem n'Mitrovicë, inxhinjeri që joshi gjermanët me ardhë me pa e afër Zagrebit me mbetë nji familje e tyne pa vazjën e re, viktimë e rrugëve t'këqia e gazetave me ba lajm! Dikush vinte nga Plava si Esati me do Sharraxhijë t'atdheut,

tjeri si Dërvish Rozhaja, dritë Universiteti e dikush nga Dibra si Dr. Kaleshi e rraja trashëj n'dhe e trangu rritej tue lëshua degë. Sot ku jemi që s'vjerremi n'degët tona n'tokën e lirë? Pse bahemi lisa pa rrajë e plisa pa koka?! Pse kaq t'etshëm për t'qenë vetëm i pari pa mustakun e Gjon Marka Gjoni e mendjen e Anton Çetës!? Pse tash s'po dimë si ata që s'patën n'xhepa por lanë vepra. Pse kaq smirëzi n'Kosovën e lirë e pse kaq t'vorfnuem n'shekullin e ri?! Nëse krypa u sos, gjollat mbetën lëndinave. Këthjelluni sa s'asht vonë mu la n'ujin e krojeve se dikur shterrën! Duejeni atdheun për me dashtë vetën!

Rugovë (Drelaj) 13.11.2020




TË STREHUARIT NË MALE

HAJDIN ABAZI

*Këtu gjithçka është mungesë edhe uji.
Ajri kristalshmëri e ndotur
heshmë e tymrash të granatave.
Lukthi duke bluar kujtimin e shujtave
kthehet në një mi brejtës.*

*Absolute këtu është
vetëm pasiguria.
Për t'i shpëtuar të ftohtit të tmerrit
ndezi zjarre shprese.
(1999)*



(Kjo poezi është botuar në sprovën për antologji "Dritë mbi plagë", botuar nga Qendra "Gjenocidi në Kosovë - Plagë e Hapur", Gjenevë. Në ditët në vijim, duke nisur nga e sotmja, në gazetën "Epoka e re", në portalin online të saj dhe në formatin Pdf po të saj, për çdo ditë do të botohen poezitë e autorëve të botuara në këtë përmbledhje)

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT
PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'**
TEL: 045/82 82 82

Sfida interesante në Superligën e basketbollit

PRISHTINË, 13 NËNTOR - Në fundjavë do të zhvillohet xhiroja e pestë në Prince Caffë Superligë. Ndeshjet do të zhvillohen në terminë jo shumë të zakonshëm në basketboll, megjithatë kjo është bërë, duke respektuar masat nga Qeveria e Kosovës. Të shtunën do të përballen rivalet e vjetra, Trepça dhe Peja. Mitrovicasit synojnë fitoren e tretë radhazi pasi mundën Golden Eagle Yllin dhe Vëllaznimit, kurse pejanët janë skuadra e vetme që ka tri fitore në po aq ndeshje të zhvilluara.

Bashkimi - Rahoveci, po ashtu, është një takim interesant. Prizrenasit kanë një fitore dhe dy humbje deri më tani, kurse 'Vreshtarët' kanë dy fitore dhe dy humbje. Ponte Prizreni, pas fitores në vazhdimë ndaj Rahovecit, do të përballen me Sigal Prishtinën, sfidë që do të zhvillohet të dielën. Ponte ka dy



fitore dhe dy humbje, kurse bardhekaltrit kanë një fitore dhe dy humbje. Ndeshja e fundit në këtë xhiro zhvillohet mes Golden Eagle Yllit dhe Vëllaznimit. Therandasit kanë dy fitore dhe një humbje, kurse e kundërta është te skuadra kuqezi që ka një fitore dhe dy humbje.

Të dielën do të zhvillohen dy ndeshje në Superligën e Femrave

Vëllaznimi dhe Bashkimi synojnë të mbesin të pamposhtur në elitën e

femrave, ku deri më tani kanë shënuar tri fitore në tri ndeshje të zhvilluara. Skuadra kuqezi do të jetë mysafire e Trepçës, që ka një fitore dhe dy humbje në këtë edicion. Vashat nga Gjakova janë favorite për të shënuar edhe një fitore të radhës. Bashkimi që ka tri fitore në tri ndeshje do të ndeshet me Kastriotin, që ka tri humbje në tri ndeshje dhe vashat prizrenase janë favorite për ta regjistruar fitoren e katërt radhazi në këtë edicion. Kujtojmë se Bashkimi fitoi edhe Superkupën, duke mundur në finale Kosovahome Prishtinën. Ndeshja Kosovahome Prishtina - Penza do të zhvillohet gjatë ditëve në vijim.

SHKURT

Vëllaznimi në gjendje të rëndë, kërkon ndihmë financiare

Vëllaznimi i Gjakovës është një nga klubet më të mëdha dhe më me traditë në futbollin e Kosovës. Por, fatkeqësisht, klubi kuqezi është në gjendje të mjerueshme financiare pasi së fundmi i është larguar edhe financuesi Shkëlzen Gashi. Kuqezinjtë kanë bërë kërkesë për ndihmë financiare nëpërmjet një postimi në rrjetin social "Facebook". "Të dashur bashkatdhetarë kudo që jeni, si çdo pore ekzistenciale e jetës e prekur nga kjo pandemi, edhe klubi ynë i dashur, emri i madh i të gjitha zemrave që rrahin fort për të, 'Vëllaznimi', është prekur rëndë në të gjitha aspektet e mundshme, e sidomos në aspektin financiar, pas heqjes dorë nga çdo financim e sponsorizim i deritanishëm. Me keqardhje të madhe duam ta ndajmë me ju, ashtu si gjithmonë, shqetësimin tonë të madh për gjendjen alarmante e të pashpresë dhe ditët më të vështira që po kalon KF Vëllaznimi", thuhet në postimin e klubit kuqezi në faqen zyrtare në "Facebook".

Feronikelit po i mungojnë rezultatet, Duron dënon futbollistët

Kryesia e Feronikelit së bashku me trajnerin Klodian Duro kanë ndërmarrë masa ndaj disa futbollistëve. Rezultatet jo të mira në xhirot e fundit kanë bërë që gjashtë lojtarë të dënohen nga trajneri Duro. Ai ka vendosur që lojtarët si Bedri Greca, Viktor Kuka, Argjend Bardhi, Alban Pnishi, Marclei Santos dhe Ardi Qorri, të stërviten ndarazi nga skuadra. Por nuk dihet se a do të llogarisë përsëri në ta për ndeshjen e ardhshme, trajneri nga Shqipëria, pasi që të gjithë kanë kontrata me klubin dhe largimi i tyre në këtë kohë është i pamundur duke ditur krizën financiare që po kalojnë klubet kosovare nga pandemia e koronavirusit. Ditë më parë Duro shkarkoi ndihmëstrajnerët, Ramiz Dervishi e Avni Hasani.

Gjasula i bashkohet Shqipërisë

Mesfushori Klaus Gjasula të premten iu bashkua Shqipërisë. Futbollisti i Hamburgut ka zënkuar herët në mëngjes në aeroportin "Nënë Tereza" të kryeqytetit duke treguar gjithçka me foto. Siç transmeton "Panorama", 30-vjeçari iu bashkua ekipit kombëtar më vonë se lojtarët e tjerë për shkak të angazhimit në kampionat me ekipin e tij Hamburgun. Mes mungesave të rëndësishme në radhët e ekipit kuqezi si: Strakosha, Kumbulla, Trashi etj., Gjasula i jep siguri trajnerit Reja për dy ndeshjet e fundit të fazës së parë të Ligës së Kombeve, ku ekipi kuqezi do të kërkojë medoemos sigurimin e vendit të parë në grup.

PRINCE CAFFE SUPERLIGA - JAVA 5

Të shtunën takohen:

14:00 Trepça - Peja

16:00 Bashkimi - Rahoveci

Të dielën takohen:

13:30 Ponte Prizreni - Sigal Prishtina

15:30 Golden Eagle Ylli - Vëllaznimi

SUPERLIGA E FEMRAVE - JAVA 4

Të dielën takohen:

12:00 Trepça - Vëllaznimi

16:00 Bashkimi - Kastrioti

Kampionati i Gjinnastikës organizohet nga 14 deri 29 nëntor



PRISHTINË, 13 NËNTOR - Federata e Gjinnastikës e Kosovës me rastin e festave të nëntorit organizon Kampionatin e Kosovës në kategori veç e veç. Fillimisht në gjinnastikën artistike për femra dhe më pas edhe për meshkuj në të njëjtin format.

FGJK-ja për shkak të pandemisë ka përpiluar planin e garave që maksimumi të jetë 20 persona në sallë dhe të shpërndahen garat në më shumë ditë, në kohëzgjatje më të shkurtër dhe me numër të kufizuar gjinnastësh, duke reduktuar

stafin, dhe numrin e pjesëmarrësve sipas udhëzimeve të Ministrisë së Shëndetësisë. Garojnë: Parayllka (14 nëntor), Yllka (15 nëntor), Parapionere (21 nëntor), Pionere (22 nëntor), Juniore (29 nëntor), Seniore (29 nëntor).

Dede merr drejtimin e Tiranës

TIRANË, 13 NËNTOR - 24 orë nga shkarkimi i nigerianit Emanuel Egbo, Tirana ka emëruar menjëherë trajnerin e ri, i cili do të jetë ish-kapiteni legjendar i bardhebluve, Nevil Dede. Lajmin e ka dhënë vetë klubi

bardheblu nëpërmjet një njoftimi zyrtar në rrjetet sociale, ndërsa në orën 14:30 pritet të bëhet edhe prezantimi zyrtar i trajnerit Dede si numri një i bankinës së kryeqytetasve. Nevil Dede ka veshur fanellën e

bardhebluve për 11 sezona në dy periudha të ndryshme dhe ka mbajtur shiritin e kapitenit, duke fituar trofe të shumtë në vend me Tiranën. Si trajner Dede e ka nisur përvojën pikërisht te klubi bardheblu, pasi fillimisht ka

qenë ndihmës në sezonin 2009-2010 dhe më pas trajner i parë në sezonin pasardhës. Në vijim Dede ka drejtuar edhe skuadra si Laçi, Luftëtari, Kastrioti e Erzeni, ndërsa aktualisht mban edhe postin e Shqipërisë U19.



Duam fitore në dy finalet dhe të përfundojmë të parët në grup

TIRANË, 13 NËNTOR - Berat Gjimeshi është një nga futbollistët më në formë në Kombëtaren e Shqipërisë, pasi prej dy sezonesh luan në nivele të larta tek Atalanta, ndërsa edhe te kuqezinjët është tashmë një titullar i padiskutueshëm. Mbrojtësi ishte në një konferencë për shtyp nga ambientet e grumbullimit të Kombëtares Shqiptare, ku bashkëbisedoi me SuperSport dhe konfirmoi besimin për arritjen e fitores në dy ndeshjet e fundit të Ligës së Kombeve.

Sa besoni te arritja e vendit të parë në grup?

Gjimeshi: Ne besojmë maksimalisht që mund t'ia dalim të fitojmë këto ndeshje dhe të marrim vendin e parë në grup. Kemi shumë lojtarë të mirë në grup, si ata me përvojë, por edhe të rinjtë si Çepele që ka ardhur së fundi.

Sa të rëndësishme kanë qenë dy sezonet e fundit me Atalantën?

Gjimeshi: Më kanë ndihmuar shumë dhe kjo shihet në fushë, por për një futbollist është shumë e rëndësishme që të luash sa më shumë. Nëse luan rregullisht, atëherë ke mundësi të korrigjosh gabimet dhe të përmirësohesh. Ka qenë e rëndësishme edhe fakti që kemi pasur gjithmonë të njëjtin trajner dhe kemi punuar shumë me të, por edhe të luajturit të Ligës e Kampionëve të jep



një përvojë të jashtëzakonshme.

Si e vlerësoni Ligën e Kombeve si garë?

Gjimeshi: Ne e marrim shumë seriozisht, pasi ka raste që kjo garë shërben si një rrugë për të shkuar në Evropian apo Botëror, ndaj i bëjmë vlerësimin maksimal.

Si i ke parë sulmuesit në seancat e fundit stërvitore?

Gjimeshi: Janë në një formë shumë të mirë dhe i kam parë shumë të

karikuar edhe në seancat stërvitore. Besoj që do të arrijnë të shënojnë në dy ndeshjet e radhës dhe të na ndihmojnë të fitojmë.

Çfarë gabimi nuk duhet të bëjmë ndaj kundërshtarëve të radhës?

Gjimeshi: Nuk duhet t'i nënvlerësojmë aspak, pasi të dy kundërshtarët dalin shumë shpejt në kundërsulm dhe duhet t'i mbajmë tërë kohës në vëmendje. Gjithsesi kemi eksperiencën e duhur për t'ia dalë me sukses.

Kroos: Bayerni është skuadra më e mirë në botë



MADRID, 13 NËNTOR - Mesfushori Toni Kroos beson se ish-skuadra e tij, Bayern Munchen, është më e mira në botë. "Për momentin, Bayern Munchen është skuadra më e fortë në botë. Nuk kam dyshime, e di se çfarë do të thotë kjo, sepse Real Madridi ka qenë për vite me radhë. Nëse fitoni Ligën e Kampionëve, jeni skuadra më e mirë. Në fakt, ata fituan gjithçka sezonin e kaluar, kanë një ritëm tjetër. Ne duhet të pranojmë që

ka skuadra më të mira se ne për momentin", ka thënë Kroos. Mesfushori gjerman ka pasur edhe një mesazh për FIFA-n dhe UEFA-n: "Kam frikë se mund të krijojnë një kuptojnë se shëndeti i lojtarëve është në rrezik. Zhvillimi i ndeshjeve kaq shpesh na lodh dhe nuk është mirë për lojtarët. Mendoj se nuk është e nevojshme të shtrydhemi kështu", ka shtuar Kroos.

SHKURT

Avdijaj rikthehet në Holandë

Donis Avdijaj është rikthyer sërish në Holandë. Futbollisti nga Kosova, pas përvojave me Trabzonsporin dhe Heartsin, ka firmosur për skuadrën e Emmenit deri në fund të sezonit. Kampionati holandez është i njohur për 24-vjeçarët, pasi në të kaluarën ka luajtur për Rodan dhe Willem 2. Shqiptari, po ashtu, ka qenë pjesë e Schalke 04.

Interi interesohet për Di Marian

Argjentinasi i PSG-së, Angel Di Maria, mund të transferohet në Serinë A. Është skuadra e Interit që po shikon mundësinë e transferimit të Di Marias. Sipas "Tuttosport", drejtuesit e Interit po planifikojnë të nënshkruajnë me mesfushorin ofensiv, nëse ai largohet falas nga PSG-ja. Kontrata e Di Maria me PSG-në përfundon në verën e vitit 2021 dhe nga janari ai është i lirë të negociojë me klubet e tjera.

Solskjaeri e ka besimin e Unitedit

Drejtori sportiv i Manchester Unitedit, Ed Woodward, ka bërë me dije se trajneri Ole Gunnar Solskjaer ka mbështetjen e bordit të klubit. Trajneri norvegjez është lidhur me një largim nga "Dajtë e Kuq" pas rezultateve të dobëta në fillim të këtij edicioni. Por klubi thuhet se ka vendosur ta mbështesë trajnerin norvegjez përkundër kësaj. Unitedi këtë sezon është në pozitën e 14-të me 10 pikë të tubuara. Së fundi Mauricio Pochettino është lidhur me klubin anglez si zëvendësues i Solskjaerit. Solskjaeri ka kontratë me Manchester United deri në vitin 2020.

Boatengu mund të transferohet në Angli

Pavarësisht prej bisedimeve për një rinovim të mundshëm të kontratës, e ardhmja e Jerome Boateng duket larg Bayernit. Mbrojtësi gjerman është në muajt e fundit të kontratës, që e lidh atë me "bavarezët", dhe destinacioni i radhës do të jetë futbolli anglez. Disa nga klubet më të rëndësishme janë në gjurmët e tij për ta afuar me parametër zero. Arsenali, Chelsea dhe Tottenhami po përgatitin ofertën e duhur për të bindur 32-vjeçarët që të transferohet në Angli.

Milani nuk i përmbush kërkesat e Calhanoglut, e ardhmja në 'Old Trafford'


Hakan Calhanoglu është personi më i përfolur në mediat italiane, pasi turku nuk po e ndërron mendimin e tij për dyfishimin e pagës. Sipas zërave të fundit nga portalet

dedikuar transferimeve, agjenti Gordon Stipiç ka kërkuar një pagë prej 7 milionë eurosh për klientin e tij. Oferta e Milanit shkon vetëm në 4 milionë plus bonuse, gjë që nuk i intereson

mesfushorit turk. Me këtë disnivel kërkesë-ofertë duket se "djalli" është duke menduar zëvendësimin e tij. Maldini dhe Gazidis do ta lejojnë transferimin e tij te

Manchester Unitedi dhe me paratë që do të përfitojnë nga shitja e tij, do të hidhen në sulm për Brahim Diazin. Spanjollit erdhi si huazim i thjeshtë pa opsion blerje, por

prishmëritë e tij janë tejkaluar. Një presion i tifozëve dhe trajnerit Pioli do t'i detyronte drejtuesit e skuadrës të bëjnë të pamundurën për t'i siguruar shërbimet e tij.



Izet Sarajliqi (1930-2002) është një ndër poetët boshnjak më të njohur. Sarajliqi është konsideruar një prej autorëve kryesorë të Evropës Lindore dhe është kandiduar për çmimin Nobel për letërsi. Sarajliqi ka qenë anëtar i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Bosnje dhe Hercegovinës. Është vlerësuar me shumë çmime, edhe me çmimin prestigjioz "Alberto Moravia" (2001).
Gjatë luftës (1992-1995) refuzoi të largohej nga Bosnja. Në këtë luftë, në të cilën u plagos, humbi dy motrat, Ninën dhe Razën, të cilat përmenden në këtë libër. Poezitë e Sarajliqit janë përkthyer dhe botuar në: italisht, frëngjisht, holandisht, gjermanisht, sllovenisht, rusisht, lituanisht, anglisht, turqisht, maqedonisht, spanjisht, në gjuhën polake e në disa gjuhë të tjera të botës, edhe në shqip.




Në parathënien e këtij libri është ky paragraf: *Në Sarajevë, të cilën e deshi shumë dhe me poezi shkruar për të e bëri të njohur në mbarë botën, pothuajse askush nuk e kujton më. Madje asnjë rrugë të këtij qyteti nuk ia dhanë emrin e tij.* Kështu shkruan dhe shpreh shqetësim e bija e poetit, Tamara Sarajliq Slavniq, e cila, në korrespondencat me postë elektronike, na njofton se babai i saj, Izeti, sa ishte gjallë kishte qenë disa herë në Prishtinë, se i donte shumë shqiptarët, se u fliste fëmijëve të vet shumë për qytetet e Kosovës, për takimet që kishte pasur disa herë me poetë shqiptarë në mbremjet poetike që atëkohë organizoheshin në Kosovë dhe në Maqedoni. Po ashtu, shpreh kënaqësi që, pas librit të parë, *Kërkoj rrugë për emrin tim*, përkthyer në gjuhën shqipe, në fund të viteve '70, nga Azem Shkreli, Enver Gjergjeku, Qerim Ujkani, Ali Podrimja dhe botuar nga *Rilindja* më 1978, po në shqipe po i përkthehet dhe botohet libri i dytë, *Përmbledhja sarajevase e luftës*. Falënderimet e saj, për shtëpinë tonë botuese dhe për ata shqiptarë që kujdesen për vlera letrare dhe njerëzore, për ata shkrimtarë që i do dhe i kërkon bota, që janë institucione të kujtesës kombëtare, që ua kujtojnë gabimet shteteve dhe udhëheqësve të tyre, janë shumë të njerëzishme dhe janë shumë miqësore. Pas shumë fjalëve të saj për punën tonë, i kemi dërguar në fund këtë fjali: *Boshnjakët edhe mund ta harrojnë luftën, edhe ta harrojnë Sarajliqin, por ne s'do ta harrojmë kurrë luftën e Bosnjës në vargjet e Izetit; s'do ta harrojmë kurrë masakrën që i është bërë popullit të tij; s'do ta harrojmë kurrë fatin e përbashkët që kishim: ju vetem atje, ne shqiptarët këtu.*

N. Sh. Armagedoni

4.99 €




PËRMBLEDHJA SARAJEVASE E LUFTËS



IZET SARAJLIQ

Përktheu: Salajdin Salihu
Shkroi parathënien: Tamara Sarajliq Slavniq





 **Gjej PUNË**

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



 www.facebook.com/gjejpuneshpejte


RESTAURANT

SWISS


TAVERNA


Tel: +377 45 400 156  +386 49 848 553


PRISHTINË


 **Lume's Details**


Estetik & Depilim



 044 900 978 | 045 681 898

 Sallon Depilimi Lume's Details

 lumesdetails

 Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Shkelzen Gashi shpall te pa vlefshme dëftesat e kl.I,II,III,IV dhe diplomën e Sh.M.Teknike "Nexhmedin Nixha " ne Gjakovë.
- Fisnik Mamusha shpall te pa vlefshme dëftesat e kl. I,II,III,IV dhe diplomën e Sh.M.E. " Kadri Kusari " ne Gjakovë.
- Jap banesë me qira afër 60 m2, kati III-Lagja Mati 1 Rr.Z3-Si Theodor Muzaka nr.14. në Prishtinë. Banesa posedon dhoma gjumi dhe sallon, kuzhinë, korridor banjo ballkon . Banesa është e mobiluar komplet, preferoj ta jap banesën me qira për afat të gjatë. Tel: +38344185233.
- Lëshoj banesë me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.
- Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepe shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.
- Lëshoj banesë me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Feja", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.
- Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Feja" Prishtinë. Tel: 044-686-900.
- Lëshoj banesë me qera në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.
- Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.
- Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.
- Urgjentisht kërkoj një banesë me qera ne Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188
- Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275
- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanët me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139
- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.
- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.
- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.
- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.
- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.
- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.
- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 Euro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)
- Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë numër të tel: 049-440-466.
- Lëshoj banesën një dhomshe me qira, ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroj i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.
- Lëshoj me qira banesën e mobiluar te salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.
- Lëshoj banesën me qira në lagjen "Ulpiana" në Prishtinë, afër AAK-së. Banesa është e mobiluar komplet. Për informata mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 044-162-783, si dhe në të njëjtin numër në viber.
- Kërkojmë 4 bashkëbanuese, studente, banesa gjendet te Parku i qytetit, kati i I-rë, ka 3 dhoma, banjo, ballkon, çmimi për person është 50 euro plus shpenzimet. Për info: 045/699-221.
- Lëshohet me qira banesa në lagjen Bregu i Diellit te furra Qërimi 2. Banesa është në katin e tretë, ka sallon dhe kuzhinë si dhe dy dhoma të fjetjes. Numri i telefonit: 044 332 640.
- Lëshohet banesa me qira në Prishtinë në lagjen "Ulpiana", afër AAK-së. Për informata lajmërohuni në tel: 044/162-783
- Lëshoj banesë me qira në Ulpianë, tek Fontana në: E 30-3A, nr.27, kati -IV-. Çmimi sipas marrëveshjes në info: 044-132-368.



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

